

VENDIM
Nr.660, datë 17.10.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.343, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE
JURIDIKË, PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 7.1 të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë e pikës 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Përballimi, nga buxheti i institucionit, i shpenzimeve për telefoninë celulare t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, pa kufizim, funksionarëve të përcaktuar në shkronjën “A” të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, ndërsa për funksionarët e përcaktuar në shkronjën “A/1”, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për funksionarët e përmendur në shkronjën “B” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe për funksionarët e shkronjës “C” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj.”.

2. Në shkronjën “A” të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, të hiqen pikat 4 e 5 dhe në fund të shtohet shkronja “A/1”, me këtë përmbajtje:

“A/1 1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;

2. Kryetari i Gjykatës së Lartë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha